



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

Nr. 18 datë 11.06.2010

PER

“ PROCEDURAT E ZGJIDHJES SE MOSMARREVESHJEVE”

Miraturar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1296, Datë 11.06.2010.

Rregullore për Procedurat e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve

Neni 1

Qëllimi

- 1.1 Qëllimi i kësaj rregulloreje është zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes sipërmarrësve lidhur me aksesin dhe interkoneksionin, si dhe me përdorimin e përbashkët të faciliteteve shoqëruese. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve kërkon një kombinim të aftësive juridike, ekonomike dhe të biznesit. Rregullatori do sigurojë që i gjithë informacioni i nevojitur për të marrë një vendim të drejtë është i disponueshëm, dhe se nuk ndikohet nga argumente të pavërteta apo të paarsyeshme të palëve. Gjithashtu do të sigurojë që në të gjitha rastet zbatohen procedurat e duhura, dhe se vendimi final mbron interesat e palës e cila nuk përfaqësohet në proces – konsumatorit. AKEP në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në zbatim të këtij dokumenti do të ketë për qëllim:
- të ofrojë zgjidhje të shpejtë dhe të vendosur për mosmarrëveshjet mes sipërmarrësve;
 - të sigurojë që të drejtat e të gjitha palëve janë respektuar;
 - të kontribuojë në përmbushjen e të gjitha objektivave rregullatore;
 - të përkrahë investime dhe konkurrencë efektive.

Neni 2

Baza ligjore

- 2.1 Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” neni 8, (germa n), neni 22 (pika 5) neni 49 (germa 2/b) neni 50, neni 60 dhe neni 120.
- 2.2 Ligji Nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”
- 2.3 Rregullore e Brendshme e AKEP miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr.170 datë 24.04.2004.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, të cilat lidhen me zbatimin e Ligjit dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 4

Perkufizime

- 4.1 “Ligj” nënkuptohet Ligji Nr.9918 dt.19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
- 4.2 “Kod” nënkupton Ligji Nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- 4.3 “Kërkues” nënkupton sipërmarrësin i cili paraqet kërkesën pranë AKEP për zgjidhjen e një mosmarrëveshje;
- 4.4 “Pala Tjetër” nënkupton sipërmarrësin ndaj të cilit mund të jetë ngritur mosmarrëveshja nga ana e kërkuesit;
- 4.5 “Palë të treta” nënkupton sipërmarrës ose palë të tjera, të cilat mund të jenë të lidhura me zgjidhjen e mosmarrëveshjes;
- 4.6 “Komisioni i shqyrtimit të mosmarrëveshjeve” komisioni i ngritur nga AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në përbërje të të cilit ka specialist nga Zyra e Mosmarrëveshjeve dhe të fushave të tjera sipas rastit (juridike, ekonomike dhe teknike).

Neni 5

Fusha e Veprimit dhe Roli i AKEP në zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve

- 5.1 Fusha e veprimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është ajo e parashikuar nga ligji që do të thotë mosmarrëveshjet lidhur me aksesin dhe interkoneksionin, si dhe me përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve ndërmjet sipërmarrësve.
- 5.2 Roli i AKEP-it në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është ligjor. Prandaj duhet të konsiderohet si një rregullator, i cili interpreton detyrat e tij në këndvështrim të objektivave të veta ligjore, dhe jo vetëm si palë e tretë ndërmjetësuese. AKEP-i ka për detyrë, sipas nenit 49 të Ligjit për Komunikimet Elektronike, të shqyrtojë mosmarrëveshjet të cilat i referohen këtij neni, ose të ndërhyjë me nismën e saj, kur marrëveshja për akses dhe interkoneksion nuk është arritur. AKEP-i duhet të mbikqyrë afatet kohore për veprime administrative të vendosura në Kodin e Procedurave Administrative. Gjithashtu gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve AKEP duhet të bazohet në parimet e Kodit të Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë.
- 5.3 AKEP-i është i detyruar të zgjidhë mosmarrëveshjet lidhur me aksesin dhe interkoneksionin, si dhe me përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve ndërmjet sipërmarrësve. AKEP-i nuk ka rol në trajtimin e formave të tjera të mosmarrëveshjes dhe i refuzon këto mosmarrëveshje nëse i drejtohen. Natyrisht, një sipërmarrës mund të paraqesë një ankesë në mënyrë të njëanshme pranë AKEP-it, për sjelljen e një operatori tjetër. Në këtë rast, për trajtimin e Ankesave Sipërmarrësve, nga sipërmarrësi kërkues pritet të paraqesë prova më konkrete se sa ato që priten nga publiku i gjërë.
- 5.4 Fusha e veprimit të kësaj rregulloreje lidhur me akses dhe interkoneksion përfshin mosmarrëveshjet mes “sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike”. Fusha e veprimit të kësaj rregulloreje, për zgjidhjen e

- 5.5 Ne rastet kur njëra palë në mosmarrëveshje pretendon se një shërbim ose facilitet i caktuar të cilin e ka kërkuar përcaktohet si akses dhe/ose interkoneksion, ndërsa pala tjetër pretendon se nuk përcaktohet si i tillë atehere çështje të tilla janë të vështira për tu përcaktuar *ex ante* dhe nëse përfundimi nuk është evident AKEP do të shqyrtojë çështjet e tilla në të njëjtën mënyrë siç e shqyrton vetë mosmarrëveshjen. Pasi të ketë pranuar mosmarrëveshjen dhe pasi të ketë filluar shqyrtimin, AKEP-i mund të vendosë se nuk ka juridiksion mbi çështjen. Në raste të tilla AKEP-i mund ta mbyllë mosmarrëveshjen pa e zgjidhur atë.
- 5.6 Për të përcaktuar nëse një mosmarrëveshje është e vërtetë dhe është brenda juridiksionit të AKEP për ta shqyrtuar, është e domosdoshme që sipërmarrësi t'i ofrojë AKEP informacionin e mjaftueshëm në shkallë të parë, për të vendosur nëse mosmarrëveshja është në juridiksionin e AKEP dhe të kalohet në shkallën e dytë të shqyrtimit. Nëse dokumentacioni origjinal i paraqitur lidhur me mosmarrëveshjen nuk përmban informacion të mjaftueshëm dhe të qartë për AKEP për të qenë i bindur nëse ka juridiksion, mosmarrëveshja do të refuzohet dhe afati kohor për të vendosur nuk do të fillojë deri sa informacioni i plotë të jetë paraqitur. Mënyra e paraqitjes së informacionit për një mosmarrëveshje përshkruhet në nenin 6 më poshtë.
- 5.7 Kur mosmarrëveshja lidhet me shërbimet e reja të cilat janë mënyra të aksesit në rrjet, kërkuuesi duhet të ofrojë një plan biznesi për paraqitjen e produktit të kërkuar, duke përfshirë parashikimet për kërkesat. Ky informacion kërkohet nga AKEP në mënyrë që të vlerësojë nëse kërkesa për një produkt të ri për akses në rrjet është e arsyeshme.
- 5.8 AKEP e kupton se sipërmarrësit mund të refuzojnë të hyjnë në negociata apo mund të krijojnë vonesa të paarsyeshme në përpjekje për të ndaluar bisedimet. Në këto raste, pala, e cila kërkon nga AKEP të zgjidhë mosmarrëveshjen, duhet të dëshmojë se ka ndërmarrë hapa të arsyeshme për të angazhuar palën tjetër në negociata tregtare. AKEP zakonisht do të pranojë, si alternativë të provave të dokumentuara të negociatave tregtare, prova të cilat sugjerojnë se njëra palë ka refuzuar qëllimisht të hyjë në negociata.
- 5.9 AKEP në përgjithësi do të pranojë një mosmarrëveshje vetëm në rastet kur pala në mosmarrëveshje paraqet informacion të qartë për të gjitha aspektet e mosmarrëveshjes. AKEP e parashikon se në disa raste përcaktimet e sakta ligjore të një mosmarrëveshjeje mund të jenë komplekse dhe të kërkojnë vlerësim të plotë dhe të detajuar para se ato të zgjidhen. AKEP do të vendosë mënyrën më të përshtatshme për të proceduar me secilën mosmarrëveshje rast për rast.

Neni 6

Parimet e AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

A. Transparenca

- 6.1 Në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve AKEP do të bazohet në parimin e transparencës që nënkupton publikimin e informacionit lidhur me mosmarrëveshjet të cilat AKEP i ka shqyrtuar ose po i shqyrton, si dhe arsyetimin për arritjen e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Kjo do të jetë një menyrë e thjeshtë efiçente dhe jo e kushtueshme për të përcjellë tek aktorët e tregut menyrën se si AKEP i konsideron lloje të ndryshme të mosmarrëveshjeve.

Keshillim për mosmarrëveshjet

- 6.2 Kur AKEP vlereson se çështja në mosmarrëveshje do të ketë ndikim në tregun e gjerë (që do të thotë se do të ketë efekt në një numër të palëve të ndryshme me interes, ose kur interesat e konsumatorëve ndikohen), për të qënë transparent, do të publikojë në web-site ose me njoftim tjetër palët, për mosmarrëveshjen si dhe një përshkrim të fushës së veprimit. Palët e interesuara dhe palët e treta do të kenë 7 ditë afat për të dërguar komentet mbi përcaktimin e publikuar të mosmarrëveshjes. AKEP do të marrë në shqyrtim edhe komentet e palëve të interesit përpara marrjes së Vendimit Përfundimtar.

B. Konfidencialiteti

- 6.3 Në zbatim të nenit 120 pika 5 të ligjit për Komunikimet Elektronike, AKEP-i është i detyruar të publikojë vendimet lidhur me mosmarrëveshjet, dhe të marrë parasysh detyrimin për mospublikimin e sekreteve tregtare të palëve. Publikimi do të bëhet në një variant publik në web-site duke mos përfshirë pjeset që kanë të bëjnë me sekretin tregtar.
- 6.4 AKEP në publikimin e vendimeve do të ketë parasysh parimin e sekretit tregtar të palëve. Megjithatë nuk do të pranojë domosdoshmërisht si të mirëqena pohimet e palëve se interesat e tyre do të dëmtohen nga publikimi i informacioneve të caktuara. Vendimet e AKEP janë të qarta dhe të arsyetuara duke treguar menyrën e shqyrtimit të çështjes dhe arsyen pse ka arritur në atë vendim. Dhënia e një informacioni të nivelit të caktuar lidhur me një biznes, si dhe paraqitjet e bëra në AKEP për mosmarrëveshjen, janë të nevojshme për të ndihmuar AKEP në zbatimin e funksioneve të tij.
- 6.5 Palët normalisht ftohen të deklarojnë nëse, dhe në çfarë baze, një informacion i caktuar është sekret tregtar dhe sensitiv kur ato i ofrojnë informacione AKEP (shih, *shtojcën I* – informacioni që kërkohet për paraqitjen e mosmarrëveshjes). Publikimi ose jo i një informacioni të caktuar është një çështje të cilën e vendos AKEP.

AKEP nëse nuk e konsideron sekret paraqitjen e argumenteve ligjore apo të politikave rregullatore i publikohen ato .

C. Afati kohor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

- 6.6 AKEP-i duhet të zgjidhë mosmarrëveshjet brenda një afati të përgjithshëm për veprime administrative të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Shqipërisë deri në 3 muaj. Në rast të një situate të veçantë, procedimi administrativ përfundon brenda 3 muajve pas përfundimit të situatës së veçantë.
- 6.7 Afatet kohore tipike për një procedurë të zgjidhjes së mosmarrëveshjes (duke përfshirë këshillimet e mundshme për procedurën) janë në *shtojcën II*.

D. Bashkeveprimi mes mosmarrëveshjeve dhe zbatimi

- 6.8 AKEP ka kompetenca që i mundësojnë të ndërmarrë veprime për të zbatuar rregullat ose ligjin për Komunikimet Elektronike. Duhet thënë se pranimi i mosmarrëveshjeve nga AKEP nuk e parandalon atë për të ndërmarrë çfarëdo veprim të përshtatshëm për zbatim, nëse hetimi mbi mosmarrëveshjen zbulon shkelje të ligjit.

E. Kompetencat lidhur me mosmarrëveshjet

- 6.9 AKEP pasi të ketë shqyrtuar mosmarrëveshjen dhe të jenë dëgjuar argumentet e palëve, nëpërmjet një Vendimi të Këshillit Drejtues, ka kompetencë të urdhërojë nënshkrimin e marrëveshjes për akses dhe interkoneksion brenda 30 diteve nga data e urdhërit. Pretendimi për mosmarrëveshje mund të tërhiqet në çdo kohë para nxjerrjes së vendimit të AKEP. Urdhëri mund të përfshijë cilindo nga kushtet e marrëveshjes për akses dhe/ose interkoneksion duke përfshirë edhe tarifatat. AKEP gjithashtu mund të bashkangjis urdhërit kushtet lidhur me paanshmërinë, transparencën, mosdiskriminimin, arësyeshmërinë dhe respektimin e afateve kohore. Moszbatimi i urdhërit brenda afateve kohore të përcaktuara do të ketë si pasojë vendosjen e gjobes sipas nenit 137 të ligjit 9918.
- 6.10 Kur një pjesë e pretendimit të paraqitur dhe një pjesë e analizës përkatëse janë kushtet e marrëveshjes për akses dhe interkoneksion, si dhe tarifatat e detyruara për shërbimet dhe/ose facilitetet e kërkura, AKEP mund të marrë vendime lidhur me kushtet dhe tarifatat. Afati kohor për zbatimin e këtyre vendimeve është një muaj pas hyrjes së tyre në fuqi.

Neni 7

Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

- 7.1 Procedurat e AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përbëhen nga 6 faza. Këto duhet të kuptohen ndërlidhur me “Afatet kohore për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” në shtojcën II.

Hapi 1. Pranimi i mosmarrëveshjes

- 7.2 AKEP-i pranon njoftimin me shkrim për mosmarrëveshjen, i cili përmban informacionin e kërkuar të përshkruar në shtojcën I. AKEP do të vendosë nëse njoftimi përputhet me përcaktimin e mosmarrëveshjes, do të vlerësojë bazën ligjore për mosmarrëveshjen dhe nëse informacioni i ofruar është i përshtatshëm. Afati maksimal për pranimin ose kundërshtimin e njoftimit është 15 ditë nga data e depozitimit të njoftimit. Brenda këtij afati kohor AKEP do të kërkojë plotësimin e të gjithë informacionit sipas shtojcës I.

Hapi 2. Vendimi për të përdorur procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përcaktimi i natyrës së mosmarrëveshjes.

- 7.3 Këshilli Drejtues merr një vendim për fillimin ose jo të shqyrtimit administrativ të mosmarrëveshjes. AKEP njofton kërkuesin, palën tjetër dhe çdo palë të tretë në këtë mosmarrëveshje, për fillimin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes. Afati kohor prej 3 muajsh fillon nga data e marrjes së njoftimit të palëve për fillimin e shqyrtimit të

mosmarrëveshjes. Njoftimi për fillimin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes si dhe përbajtja e mosmarrëveshjes do të botohen edhe ne web-site te AKEP.

Keshilli Drejtues ngre një komision për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Komisioni përbëhet nga specialistë të Zyres së Mosmarreveshjeve dhe të fushave të tjera sipas rastit (juridike, ekonomike dhe teknike), në varësi të mosmarrëveshjes së paraqitur. Anëtarët e Komisionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nuk do të marrin pjesë në zgjidhjen e nje mosmarreveshjeve kur gjenden në rastet e konfliktit të interesave, sipas ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. (ne kundërshtim me nenin 27 dhe 80 të KprA)

- Komisioni zhvillon procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, mbledhë, shqyrton dhe përgatit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për mosmarrëveshjen.

- 7.4 AKEP do të njoftojë palët për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm, pretendimet në lidhje me mosmarrëveshjen e lindur.

Hapi 3. Përgjigje ndaj pretendimeve

- 7.5 Nga data e njoftimit të vendimit të AKEP për të përdorur procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në Hapin 2 , paleve u kërkohet që t’u përgjigjen deklaratave (sqarimeve dhe pretendimeve) të kërkuesit brenda 15 ditëve, në kontekst të qëllimit të mosmarrëveshjes siç është përcaktuar nga AKEP.

Hapi 4. Procedura hetimore nga AKEP

- 7.6 Duke u bazuar në analizën e detajuar e të gjitha paraqitjeve, komisioni për zgjidhjen e mosmarreveshjes mund të ndërmarrë procedurat si më poshtë:

(I) Të kërkojë më shumë informacion me shkrim nga palët;

(II) Të takojë palët, së bashku ose veçantë;

(III) Vendos që çështja, pjesërisht ose plotësisht, nuk përbën një mosmarrëveshje rregullatore të vërtetë dhe se do të trajtohej në mënyrë më efektive nëpërmes mekanizmave të tjerë.

Kjo procedurë nuk do të zgjase me shumë se 30 ditë.

- 7.7 Me përfundimin e hetimit, Komisioni i shqyrtimit të mosmarrëveshjeve përgatit një raport përmbledhës të të gjithë hapave të ndjekur dhe përfundimeve të arritura nga shqyrtimi i mosmarrëveshjes. Në këtë raport përfshihen pretendimet e palëve të interesuara, historia e procedimit dhe formulon një mendim paraprak për vendimin përfundimtar, duke përmbledhur arsyet ligjore dhe faktike që, sipas vlerësimit të tij, e justifikojnë vendimin, përfundimet për çështjen, me një projekt vendim dhe/ose projekt urdhër që kërkon nënshkrimin e marrëveshjes për akses dhe interkoneksion brenda 30 ditëve nga data e urdhërit. Urdhëri mund të mbulojë cilindo nga kushtet e marrëveshjeve për akses dhe / ose interkoneksion, duke përfshirë tarifën. AKEP gjithashtu mund të bashkëngjijë urdhërit kushtet lidhur me paañësinë, transparencën, mosdiskriminimin, arsyeshmërisë dhe respektimin e afateve kohore. Raporti së bashku me projekt vendimin

dhe/ose projekt urdhërin i paraqiten Këshillit Drejtues brenda 30 ditëve nga përfundimi i hetimit.

Hapi 5. Seanca degjimore nga Keshilli Drejtues

- 7.8 Përpara marrjes së vendimit, nese e cmon Këshilli Drejtues mund te therrase palet ne seance degjimore. Palëve ju jepet nje afat jo më pak se 10 ditë kohe për tu paraqitur në seancë dëgjimore. Njoftimi për seancën dëgjimore përfshin ceshtjet qe do te trajtohen nga Keshilli Drejtues ne seance degjimore.
- 7.9 Në seancë, palët në mosmarrëveshje mund të japin argumente me gojë ose me shkrim, dhe kanë të drejtë të përfaqësohen ligjërisht.
- 7.10 Pas seancës dëgjimore, Keshilli Drejtues i AKEP nese e cmon mund ti kerkoje Komisionit te shqyrtimit të mosmarrëveshjeve qe të rishikojë dhe përditësojë raportin dhe Draft Vendimin në mënyrë që të pasqyrojë provat e dhëna gjatë seancës dëgjimore si dhe përgjigjet, nëse ky dokument ka ndryshuar gjatë seancave dëgjimore. Përditësimi i Raportit dhe Draft Vendimit do të bëhet brenda 5 ditëve nga përfundimi i seancës dëgjimore. Pas perditësimit te Raportit dhe Draft Vendimit, Keshilli Drejtues merr vendim perfundimtar.

Hapi 6. Përfundimi dhe publikimi

- 7.11 Vendimi përfundimtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të miratohet nga Këshilli Drejtues dhe ju njoftohet palëve sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative. Vendimi Përfundimtar duhet të përmbajë të plota dhe të qarta arsyet për vendimin e AKEP. Vendimi nuk do të përjashtojë mundesine e i cilësdo pale per te ushtruar te drejten e veprimit para gjykatës.
- 7.12 AKEP do te publikojë ne faqen e tij zyrtare versionin publik të Vendimit Përfundimtar lidhur me mosmarrëveshjet, duke marrë parasysh detyrimin për mospublikimin e sekreteve tregtare të palëve.

Neni 8

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn ne fuqi menjehere.

SHTOJCA I

INFORMACION MBI FORMEN E KERKUAR PER TE PARAQITUR NJE MOSMARRËVESHJE

Lloji i informacionit	Informacioni i kërkuar
Të dhënat e kontaktit	Të dyja palët: Emri dhe Adresa e Plote Nr. tel E-mail
Përcaktimi i mosmarrëveshjes	Përshkrim i detajuar dhe i qartë i mosmarrëveshjes. Kjo duhet të përmbajë përshkrimet për produktin/shërbimin në qoftë se është e rëndësishme.
Baza e mosmarrëveshjes	Baza specifike ligjore e mosmarrëveshjes, duke ju referuar klauzolave ligjore /kontraktore kur është e nevojshme dhe baza ligjore për ndërhyrjen e AKEP-it.
Konteksti tregtar	Përshkrim i qartë dhe gjithëpërfshirës i kontekstit tregtar të mosmarrëveshjes
Mekanizmi i preferuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve	Mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes i preferuar nga kërkuesi
Përpyekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen	Duhet të ofrohen prova gjithëpërfshirëse lidhur me përpyekjet nga të dyja palët për të zgjidhur çështjen, në veçanti për bisedimet tregtare. Kjo duhet të përmbajë njoftimin nëse mosmarrëveshja është paraqitur para ndonjë organi tjetër.
Provat e dokumentuara	Të gjitha pretendimet duhet mbështetur me

	prova të dokumentuara kur kjo është e mundur.
Deklarata nga zyrtari	Deklaratë nga zyrtari i kompanisë, preferuar nga Drejtori Ekzekutiv, që kompania i ka bërë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur çështjen nëpërmjet të bisedimeve tregtare.
Ndikimi i mosmarrëveshjes	Kjo përfshin ndikimin që ka mosmarrëveshja në biznesin e kërkuarit . Nëse është e mundur kjo duhet të përcaktohet në mënyrë sasiore.
Masat rregullatore të propozuara	Përfundimi i pritur nga kërkuari, me arsytet.

Informacioni duhet të paraqitet duke pasur parasysh se do ti dërgohet palës tjetër në mosmarrëveshje nëse nuk është i shënuar si konfidencial. Të gjitha kërkesat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes duhet ti dërgohen Zyres së Mosmarrëveshjeve në AKEP

[pozicioni]

Adresa:

me email **[adresa elektronike]**, ose

me faks **[numri i faksit]**

SHTOJCA II

KALENDARI PER ZGJIDHJEN E MOSMARRREVESHJEVE

T_0 përfaqëson datën kur paraqitet një kërkesë. Koha nga T_0 është në ditë kalendarike. Ju lutem vini re se datat e dhëna në kolonën 1 përfaqësojnë afate absolute. Hapat ose detyrat mund të plotësohen para këtyre datave.

Data	Hapi	Veprimi
$T_0 - 23$		Depozitimi i njoftimit për mosmarrëveshjen. AKEP kërkon plotësimin e të dhënave në lidhje me njoftimin
$T_0 - 8$	Hapi 1	Njoftimi për mosmarrëveshjen është sipas shtojcës I.
T_0	Hapi 2	<p>AKEP merr vendim për fillimin e procedurës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Njofton palët për fillimin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes ➤ Ngarkon Zyren e Mosmarreveshjeve ose ngre Komision per zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ➤ Njofton palët për depozitimin e fakteve dhe pretendimeve
$T_0 + 15$	Hapi 3	Palët depozitojnë fakte, dokumentat dhe pretendimet .
$T_0 + 30/45$	Hapi 4	<p>Analiza e Komisionin në lidhje me faktet dokumentat dhe pretendimet e palëve</p> <p>Komisioni mund të kërkoje informacion të mëtejshëm prej palëve ose të takohet me ta.</p>
$T_0 + 20/65$		Komisioni i shqyrtimit të mosmarrëveshjeve përgatit raportin, projekt vendimin/ urdhër për lidhje marrëveshje dhe arsyetimin në lidhje me hetimin që ka kryer dhe ja paraqet

		Këshillit Drejtues
T ₀ + 10/75	Hapi 5	Këshilli Drejtues shqyrton raportin dhe projekt vendimin e paraqitur nga Komisioni i shqyrtimit të mosmarrëveshjeve.
T ₀ + 10/85		Këshilli Drejtues fton në seance dëgjimore palët: <ul style="list-style-type: none"> (i) Kryetari i Këshillit Drejtues emëron Kryetarin e Seancës Dëgjimore (ii) AKEP-i përcakton datën e seancës dëgjimore dhe u dërgon palëve njoftimin i cili përfshin përfundimet e raportit të hartuar.
		Komisioni i shqyrtimi të mosmarrëveshjeve përditëson raportin përkatës , duke përfshirë një ProjektVendim dhe/ose Projekt -Urdhër të Këshillit Drejtues atje ku është e përshtatshme, pas përfundimit të seances dëgjimore.
T ₀ + 5/90	Hapi 6	Këshilli Drejtues merr vendimin përfundimtar. Vendimi Përfundimtar iu dërgohet palëve, dhe nëse AKEP-i mendon se është e përshtatshme, e publikon në faqen e internetit, duke marrë parasysh kërkesat për fshehtësi. Palëve u jepet vendimi përfundimtar dhe publikohet, duke përfshirë dhe urdhërin përfundimtar të Këshillit Drejtues, ku është e përshtatshme.